

Ekskluzive

Ekskluzive | U ndal për tejkalim shpejtësie në Pejë – Policia i gjen marihuanë dhe armë në veturë



Sinjali.com

02 Gusht 2026 12:21



Një kontroll rutinë i Policisë për shkelje në trafik ka zbuluar armë dhe substancë të dyshuar narkotike në një veturë në Pejë, duke çuar në arrestimin e një të riu.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Albes Veseli rreth 22-vjeçar**.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të 2 gushtit, rreth orës 01:40, në fshatin Vitomiricë të Pejës, ku njësia e Trafikut Rajonal kishte ngritur pikë kontrolli.

I dyshuari, që po drejtonte një veturë Volkswagen, është ndaluar fillimisht për tejkalim të shpejtësisë.

Gjatë kontrollit të dokumenteve dhe automjetit, zyrtarët policorë kanë vërejtur në dorën e tij një qese najloni me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë. Më pas, gjatë kontrollit të veturës, nën ulësen e pasagjerit është gjetur edhe një pistoletë e kalibrit 9 mm P.A.K., një karikator dhe gjashtë fishekë të kalibrit 7.65 mm.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë hetuesit dhe njësia e Krimteknikës, të cilët kanë sekuestruar armën, municionin dhe substancën e dyshuar narkotike në cilësinë e provave materiale.

I dyshuari është arrestuar dhe është shoqëruar në njësinë e hetimeve për intervistim.

Me udhëzim të Prokurorit të Shtetit, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”.

Pas përfundimit të procedurave, Albes Veseli është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.


Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

Policia

Peje

arme

Të tjera:



Ekskluzive | Policia e ndal në pikë kontrolli në Gjakovë – 46-vjeçarit i gjendet pistoletë me 2...

Siguri



Ekskluzive | Tentoi ta nxirrte djalin nga Stacioni Policor – 43-vjeçarja dyshohet se...

Sinjalizime



Policia kërkon ndihmën e qytetarëve për gjetjen e Xhafer Raçit, i zhdukur që nga 2 korriku

Siguri



Ekskluzive | Bastisja për të shtënat me armë eskalon në Hajvali – dy persona sulmojnë...

Sinjalizime



Ekskluzive | Të shtëna me armë në restorantin “Iliria De Luxe” në Podujevë – 24-vjeçari...

Sinjalizime



Ekskluzive | Arrestohet 49-vjeçari në Gjakovë – Policia i gjen pistoletë “SIG Sauer” dhe fishek...

Sinjalizime



Ekskluzive | Antidroga godet pranë “Sonn Cafe” në Podujevë – arrestohet 26-vjeçari ...

Sinjalizime



Ekskluzive | Babai ia dha armën djalit 16-vjeçar për të shtënë në aheng – Policia bastis shtëpinë...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera